



Nr. 5028/1 Prot
Dt. 11.10.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr 629/1prot.

Shkodër, më 7.10.2022

LËNDA: Mbi vendimin Nr.58 datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, neni 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 shkronja e/1, neni 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25/1/b, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, pika 49, shtojcës nr.47, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shyrimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik”, pika 2 germa a, dhe pika 7, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkia Vau-Dejës datë 23.09.2022 dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkia Vau-Dejës Nr.5022prot datë 28.09.2022 u shqyrtua VKB Nr.58 datë 23.09.2022 Vau-Dejës “Për dhënie në përdorim me afat 9-vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 2.733 ha të ekonomisë pyjore Gomsiqe (ngastra nr.41) “Për Mbarështimin e florës se egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme¹”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim konform procedurave të mëtejshme ligjore, duke bërë përditësim të tarifave të reja sipas ndryshimeve ligjore miratuar me VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore”, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit publik nga Autoriteti Publik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ Elementi i rinovimit është pjesë e dispozitave të kontratës gjatë zbatimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 58 datë 23.09. 2022

“Për dhënien në përdorim me afat 9-vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 2.733 ha “për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” .

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor/ kullosor publik me shumice te cilsuar votash:

V E N D O S I

1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total 2.733 ha “për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” dhe bën pjesë në ngastrën nr.41 në ekonominë pyjore gomsiqe, sipas listës së inventarit,shtojca nr.47 dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

2.Afati i dhënies me qera të jetë 9 (nëntë) vjet me te drejte rinovimi.

3. Tarifat e dhenjes me qira duhet të vendosen në kontratë pas konkurimit publik sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

4.Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.

5. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, dhe Turizmit dhe mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e ketij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

**K R Y E T A R
MARK BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN ÇELEPIJA

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022